

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
OBJEKTIN PËR PRODHIMIN E TUBAVE TË PLASTIKËS
(PP, HDPE)

7
FERPLAST



Investitor dhe aplikues : Rrahim Krasniqi B.I. _____
N.T.P. “ Ferplast” Nr.Unik 810641002, K.Ferizaj

Mr.inxh.dip.Vehbi Goxhuli *Vehbi Goxhuli*
Nr.i licensës 25/19; E-mail vehbigoxhuli@yahoo.com;
Tel mobil: +383/49380301; +383/44330322

Shkurt, 2024

**Kompania: N.P.T.”Ferplast” Rrahim Krasniqi B.I.
Komuna Ferizaj**

Pronari: Rrahim Krasniqi _____

**Për hartimin e Raportit të :
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS–(VNM)
PËR :OBJEKTIN**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR OBJEKTIN PËR PRODHIMIN E
TUBAVE TË PLASTIKËS (PP, HDPE)**

E AUTORIZON : Mr.inxh.dipl.Shkn.Tekm.

Vehbi Goxhuli 

**Nr.i licensës 25/19
Mitrovicë**

HARTUESI E RAPORTIT PËR VNM

Mr.inxh.dipl.Shkn.teknike. Vehbi Goxhuli Nr.i licensës 25/19

TEL: : 044/330322 DHE 049/380301

E-mail:vehbigoxhuli@gmail.com; vehbigoxhuli@yahoo.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja

Në bazë të nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03L/214 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raportëve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, për Hartues të Raportëve të VNM, Ministri i MMPH lëshon:

Nr. i licencës: 25/19

LICENCË

Vehbi GOXHULI, Mr.sc.inxh.dipl.i shk. Teknike

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

Data e vlefshmërisë:
12.08.2019— 12.08.2024
Prishtinë



Fatmir Matoshi

Ministër i MMPH-së

1 HYRJE

Zhvillimi ekonomik në nivel rajonal është vendimtar për të bërë të mundur mjedis të përshtatshëm për sipërmarrjen dhe zhvillimin e biznesit. Qëllimi primar i analizave të kryera dhe i këtij raporti është të përshkruajë një dokumentim mjedisor dhe social, sa i përket zbatimit të projektit, vlerësimin e ndikimit të mundshëm të projektit mbi mjedisin ekosistemin, dhe si pasojë të identifikojë dhe propozojë ndërhyrjet, respektivisht masa për zbutjen e ndikimeve të mundshme eventualisht nëse evidentohen si ndikim negativ sa do i vogël qoft ai ndikim.

Përmes këtij studimi mundë që të krijojmë një bazë e cila duhet të shërbej si një orientim dhe harmonizimin e të dhënave dhe mjeteve për hartimin e mëtejshëm të Raportit të VNM projektit.

Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) për ndërtimin e OBJEKTIT PËR PRODHIMIN E TUBAVE TË PLASTIKËS (PP, HDPE), që bazohet nga gjendja reale në terren, dokumentacioni tekniko investiv nga niveli komuna përkatës dhe konsultimi me kompani investuese. Vlen të theksohet se Kompania NPT Ferplast tani më e në vazhdimsi është me traditë shumë të suksesëshme edhe është në koherence me trendet më të avansuara në këtë profil prodhues, pasi që është themeluar në vitin 1996, deri më tani në vete posedon 15 linja prodhimi me një numër prej mbi 100 punëtorëve të rregullt.

Veprimtaria që zhvillohet në Objektivin për prodhimin e tubave nga plastika, është e ngjajshme apo identike me Fabrikën NPT Ferplast që vepron në Komunën e Ferizajt, natyrisht janë investitorët e kompanisë NPT Ferplast. Mirpo që tani do të investojnë për të njejtën veprimtari me kapacitet e reja për prodhimin e tubave të plastikës dhe rezervuarëve për si depozita të ujit, në zonën industriale e quajtur Babush i Ri, zona kadastrale Babush i Serbëve, në kuadër të drejtorisë gjeodete kadastrale të Komunës së Ferizajt. Që nga themelimi e deri më sot kompania NPT Ferplast ka arritë të jetë prezent në tërë tregun Kosovar dhe të jetë eksportuese në shumë vende ballkanike dhe Evropiane. Bazë e prodhimit të kompanisë NPT Ferplast është:

1. Tuba të kanalizimit - sistemi i korriguar dhe Krah Pipe nga Ø 110 deri Ø 2000.
2. Tuba të ujësjellësit nga Ø20 deri Ø630 me presione PN 6, PN10, PN16, PN20, PN 25 dhe Pn32.
3. Tuba drenazhimi Ø110 deri Ø 160
4. Tuba për kablllo elektrike Ø 40 deri Ø 160
5. Tuba kanalizimi shtëpiak PP-H nga Ø 50 deri Ø 160
6. Tuba për kanalizim nga PVC Ø 110 deri Ø 315.

Për nga kualiteti kompania Ferplast ka arritur standardet më të larta Evropiane ku si garancion i kësaj është:

1. Laboratori i mbrendshëm i FERPLAST-it 2.
2. Çertifikimi me ISO 9001-2008 dhe ISO 14001-2004 të çertifikuara nga QEC – Angli
3. Çertifikim nga “RESEARCH INSTITUTE BUILDING MATERIALS”- Bullgari Ferplast punon me një teknologji të sofistikuar Gjermane dhe Italiane.

Ndikimet dhe mundësitë që ndërlihen me ndërtimin dhe operimin e OBJEKTIN PËR PRODHIMIN E TUBAVE TË PLASTIKËS (PP, HDPE) dhe të rekomandojë masa të duhura lehtësuese për të parashikuar dhe shmangur, ndikimin në mjedis qoftë në mënyr të drejt për drejt apo tërthorazi , të minimizojë, si dhe nëse mbesin ndikimet nën përqëndrimin maskimal të lejuar, të kompensojë apo të ofrojë baraspeshën për ato ndikime.

Në hartimin e raportit të VNM-së, është marrë në konsideratë gjendja fizike në terren si dhe të gjitha studimet mjedisore relevante për zonën e projektit. Gjithashtu është marrë në konsideratë edhe korniza legjislative në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe direktivat e BE-së. Raporti i VNM-së do të analizojë ndikimet mjedisore të të gjitha operacioneve teknologjike për ndërtimin e Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës (PP, HDPE), dhe aktiviteteteve për prodhimin e energjisë elektrike, duke siguruar masat e nevojshme dhe për të marrë masa për të mbrojtur mjedisin në zonën ku do të realizohet projekti. Karakteristikat e gjendjes së mjedisit në zonën e ndërtimit të OBJEKTIN PËR PRODHIMIN E TUBAVE TË PLASTIKËS (PP, HDPE)do të analizohen gjithashtu përmes raportit të VNM-së, rëndësia që mund të ketë ky projekt në të ardhmen, si dhe karakteristikat teknike inxhinierike - që do ta shoqërojnë Projektin.

Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të merret për bazë identifikimi i ndikimeve negative në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit të OBJEKTIN PËR PRODHIMIN E TUBAVE TË PLASTIKËS (PP, HDPE), gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteteve prodhuese në Objektivin për prodhimin e tubave të plastikës dhe pas fazës së përfundimit të aktiviteteteve prodhuese në OBJEKTIN PËR PRODHIMIN E TUBAVE TË PLASTIKËS (PP, HDPE) në lokalitetin Babushi i Ri, Zona Kadastrale Babushi i Serbëve në ngastrën nr: P-72209079-00913-0, me një sipërfaqe prej S= 41939 m² që i përket Komunës së Ferizajit.

Objekti për prodhimin e tubave të plastikës edhe më tutje synon të përmirësojë zhvillimin social dhe ekonomik në rajonin Kosovës në veqanti dhe më gjerë edhe në shtetët rajonale.

Përfitimet nga prodhimi i tubave plastike është i shumë fishtë, pasi që janë efikas , e kanë qëndrueshmërin të madhe , nuk e ndotin tokën , nuk dekompozohen si dhe disa veti shumë me rëndsi për mbrojtjen e mjedisit që do i cekim në kapitujt në vijim gjatë përgatijes dhe hartimit të Raportit të VNM në formë të Elaoratit për Mbrojtjen e Mjedisit

Në hartimin e raportit të VNM-së, është marrë në konsideratë gjendja fizike në terren si dhe të gjitha studimet mjedisore relevante për zonën e projektit. Gjithashtu është marrë në konsideratë edhe korniza legjislative në fuqi nga MMPHI në kuadër të Republikën e Kosovës si dhe direktivat e BE-së.

Raporti i VNM-së do të analizojë ndikimet mjedisore të të gjitha operacioneve teknologjike për ndërtimin e Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës elektrike, duke siguruar masat e nevojshme dhe për të marrë masa për të mbrojtur mjedisin në zonën ku do të realizohet projekti.

Karakteristikat e gjendjes së mjedisit në zonën e ndërtimit të Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës do të analizohen gjithashtu përmes raportit të VNM-së, rëndësia që mund të ketë ky projekt në të ardhmen, si dhe karakteristikat teknike inxhinierike - që do ta shoqërojnë Projektin.

Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të merret për bazë identifikimi i ndikimeve negative në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit të Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës , gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve prodhuese në Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës dhe pas fazës së përfundimit të aktiviteteve prodhuese në Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës në lokalitetin

Babushi i Ri, që i përket Komunës së Ferizajit.

2.0. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VNM-SË

Kosova ka legjislacion Mjedisor dhe Social që rregullon politikën, procedurat dhe mekanizmat për mbrojtjen e mjedisit, punën dhe kushtet e punës, dhe angazhimin e palëve të interesuara. Ky kapitull paraqet një përmbledhje të kuadrit rregullator kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë politikën, legjislacionin, kërkesat, udhëzimet dhe standardet e zbatueshme për Projektin. Në prani të standardeve të shumta që vijnë nga burime të ndryshme rregullatore, Projekti do të zbatohet standardet më të rrepta për të mbrojtur mjedisin dhe komunitetet që mund të preken nga projekti.

2.1 Korniza Ligjore Kombëtare e Mjedisit

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (03/L-025) është dokumenti juridik i nivelit më të lartë mjedisor në Kosovë që rregullon parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes, rregullon monitorimin e mjedisit dhe përcakton parimet e mbrojtjes së mjedisit krahas zhvillimit ekonomik . Sipas këtij ligji, projektet e planifikuara, përfshirë ndryshimet në teknologji, rindërtimin, dhe zgjerimin e objekteve ose ndërprerjen e operacioneve, të cilat mund të rezultojnë në ndikim të madh mjedisor ose që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut, kërkojnë Vlerësimin paraprak të Ndikimit në Mjedis (VNM).

Procedura për zbatimin e një VNM gjithëpërfshirëse përshkruhet në ligjin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (08/L-181).

Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) rregullon procedurat për identifikimin dhe ekzaminimin e projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, dhe përveç kësaj, ai përshkruan aspektet, përmbajtjen, fushën e vlerësimit, raportimit dhe procedurat e administrimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projekteve të propozuara për të siguruar të

gjithë informacionin përkatës në lidhje me mjedisin, në mënyrë që të mundësohet dhe lehtësohet procesi i vendimmarrjes. Në bazë të vlerësimeve të ndikimit në mjedis, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI) lëshon pëlqimin e mjedisit të kërkuar për çdo projekt publik ose privat (të shënuar në Shtojcën I ose Shtojcën II të këtij Ligji), që ka të ngjarë të ketë efekte domethënëse në mjedis duke u mbështetur, ndër të tjera, në natyrën, madhësinë ose vendndodhjen e saj.

Kryerja e procedurës së VNM në përputhje me Legjislacionin e Kosovës paraqitet në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

Pasi që zona e dedikuar për biznes si zonë Industriale, apo zonë ekonomike, sigurisht se krahas Vlersimit Strategjik Mjedisor për këtë zonë, po ashtu pastaj për secilin Operator prodhues apo Operator shërbyes që kanë planifikuar të investojnë në atë zonë, ao të aplikojnë në procedurat për pëlqim mjedisor, dhe do të përmbushë të gjitha kriteret dhe rreuglloret në kuadër të legjislacionit vendor të MMPHI, përkatësisht duke filluar nga Ligjit për VNM, Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, për të vazhduar me legjislacionon relevant në mbrojtjen e mjedisit

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis –VNM është aprovuar dhe ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Ligji Nr.08/L-181 për VNM), i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të Raportit të VNM-së dhe mundson një vlerësim të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvoglojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Sipas Gazetës zyrtare të Republikës së Kosovës, viti /Nr: 83/29 tetor 2010, (Ligji Nr.08/L-181 për VNM), informatat janë kompletuar për Operatorin Ekonomik përmes mënyres së implementimit të Ligjit Ligji Nr.08/L-181 për VNM.

Nenit 15 – Përmbajtja e raportit të VNM, Nenit 16 – Përpiluesit te Raportit të VNM-së

Gjatë hartimit të Raportit të VNM për Operatorët Ekonomik, aplikuesi dhe hartuesi kanë përgjegjësi për saktësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave të përfshira në Raportin e VNM për operatorin ekonomik që i përket aplikuesit.

Raporti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis –VNM, është hartuar mbi bazë të:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L0-25
 - Ligji për ndërtim Nr.04/L-110;
 - Ligji për Planifikim Hapsinor Nr. 04/L-147.
 - Ligji Nr.03/L-120 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Udhëzimi administrative për nivelet maksimale të lejuara të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve në tokë.

- Duke u nisur nga fakti se një pjesë e madhe e marrdhënieve specifike nga lëmia e mjedisit nuk është përfshirë në rregullativat e tanishme prandaj për nevoja të këtij raporti është shfrytëzuar përvoja e mirë dhe rregullativa relevante ndërkombëtare.

Raporti i VNM-s përfshin përshkrimin e masave mbrojtëse për mjedisin edhe me rastin e ndonjë aksidenti ambiental gjatë funksionimit të vazhdueshëm-të Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës HDPE PP

Sipas ligjit, procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen projektet e shtojcës 2 dhe është mbështetur në:

- - Direktiven 85/337/EEC të Këshillit të Europës,
- - Direktiven 2001/42/ECE të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës,
- - Direktiven 2004/35/CE të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës.

Nga informatat e grumbulluara të cilat kanë të bëjnë me elementet nismëtare për hartimin e këtij elaborati, me rëndësi të veçantë janë të dhënat që kanë të bëjnë me karakteristikimet sasiore të gjendjes ekzistuese të karakteristikave natyrore, si dhe ndrrimet e mundshme që mund të paraqiten në veçoritë e karakteristikave natyrore gjatë ndërtimit të Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës , janë paraqitur detajisht në mënyrë të specifikuar hollësisht në dokumentacionin e projektit teknik dhe këto janë shfrytëzuar gjerësisht gjatë hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis-VNM.

3.0. BAZA LIGJORE PËR HARMONIZIMIN E KRITEREVE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Si rrjedhojë e një legjislacioni mjedisor relativisht të ri që është në zhvillim dhe në implementim dhe po plotësohet më tej sidomos me rregullore, udhëzime administrative dhe standarde..

Aplikimet për VNM kane si detyrim paketën ligjore te mëposhtme:

3.2. LIGJET THEMELORE përfshijnë:

Ligji për VNM (Ligji Nr.08/L-181 -Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis);

Ligji Nr03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT;

Ligji Nr. 04/L-060 PËR MBETURINA; i plotsuar edhe me Ligji Nr. 04/L-060

Ligji Nr.04/L -197 PËR KIMIKATE;

Ligji Nr.03/L-042 I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE;

- Ligji Nr. 02/L-102; 2007 10 Gusht 2011 –Ligji për mbrojtjen nga zhurma
- Ligji i Inspektoriatit të MMPHI-së 04/L-175.
- Ligji Nr;03/L-215 për qasje në dokumentacione (në dokumentet publike).

Ligji për VNM (Ligji Nr.08/L-181 -Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis);;

Ligji Nr. 04/L-060 për mbeturina

- Ligji Nr. 02/L-102; 2007 10 Gusht 2011 –Ligji për mbrojtjen nga zhurma/
- Ligji i Inspektoriatit të MMPHI-së 04/L-175.
- Ligji Nr;03/L-215 për qasje në dokumentacione (në dokumentet publike).
- Udhëzimi administrativ nr. 02/2017 për listën e kategorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës, nënshkruar më datë: 02.05.2017.

U.A. Nr.07/2016 për sistemin e informacionit mjedisor

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe angazhohet hartuesi i raportit të VNM të përfaqësuar pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm.

Direktivat me kryesore :

- Sipas Gazetës zyrtare të Republikës së Kosovës/ Prishtinë , viti V/Nr: 83/29 tetor 2010, - Ligji Nr.08/L-181 për VNM, Informatat shtesë janë kompletuar për raportin e VNM përmes mënyres së implementimit të Ligjit Nr.08/L-181 për VNM.

3.1. Rregullativa ligjore

- Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është pothuajse në përputhje me normativat evropiane të mbrojtjes së mjedisit
- Në mbështetje të nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 është hartuar udhëzimi administrativ për aplikim në MMPHI ku qëllimi i tij është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative që mundt të kenë impakt mjedisor prej projekteve të propozuara, publike dhe private.

Ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat e procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e MMPHI për Pëlqim Mjedisor, dhe siguron të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin e që janë ofruar dhe janë marrë parasysh.

- Gjithashtu janë konsultuar edhe udhëzimet administrative në fuqi të ligjeve të lartcekura.
- Dokumentacioni teknik . Gjatë hartimit të raportit për VNM, përpos eksperiencës profesionale në udhëheqjen këtij procesi janë vënë në konsiderim edhe të gjitha dokumentet lidhur me kompaninë NPT Ferplast . si dhe pershkrimi i projektit edhe në aspektin e prodhimit të tubave nga plastika

- . Duke pas parasysh se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të dokumenteve të lartcekura për nevojat e hartimit të këtij raporti janë shfrytëzuar edhe direktiva relevante ndërkombëtare./

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale rregullon procedurat dhe lëshimin, vlefshmërinë dhe aspektet e tjera të vlerësimit mjedisor në nivel komunal. Raporti i Lejes Mjedisore Komunale kërkohet në bazë të shqyrtimit të Shtojcës II të Ligjit për VNM, kriteret e Shtojcës III dhe vendimet e MMPHI.

Ligji mbi Ndotjen dhe Kontrollin e Parandalimit të Integruar (08/L-145) transponon Direktivën e BE-së 2008/1/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 janarit 2008 në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes. Sidoqoftë, udhëzimet shoqëruese për teknikat më të mira të disponueshme dhe kufijtë e pranueshëm nën-përqëndrimin maksimal të lejuar sipas parametrave reprezentativ që monitorohen

4.0. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT GJATË PËRGATITJES SË RAPORTIT TË VNM

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (03/L-025) është dokumenti juridik i nivelit më të lartë mjedisor në Kosovë që rregullon parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes, rregullon monitorimin e mjedisit. Sipas këtij ligji, projektet e planifikuara, përfshirë ndryshimet në teknologji, rindërtimin, dhe zgjerimin e objekteve ose ndërprerjen e operacioneve, të cilat mund të rezultojnë në ndikim të madhë mjedisor ose që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut, kërkojnë vlerësimin paraprak të Ndikimit në Mjedis (VNM). Procedura për zbatimin e një VNM gjithëpërfshirëse që përshkruhet në ligjin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (08/L-181).

Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) rregullon procedurat për identifikimin dhe ekzaminimin e projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, dhe përveç kësaj, ai përshkruan aspektet, përmbajtjen, fushën e vlerësimit, raportimit dhe procedurat e administrimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projekteve të propozuara për të siguruar të gjithë informacionin përkatës në lidhje me mjedisin, në mënyrë që të mundësohet dhe lehtësohet procesi i vendimmarrjes.

Në bazë të vlerësimeve të ndikimit në mjedis, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI) lëshon pëlqimin e mjedisit të kërkuar për çdo projekt publik ose privat (të shënuar në Shtojcën I ose Shtojcën II të këtij Ligji),

Për nevojat e këtij hulumtimi është shfrytëzuar rregullativa ligjore në fuqi , me të cilën janë krijuar disa parakushte ligjore në domenin e gjerë të mjedisit e që kanë rëndësi të caktuar për

shpjegimin e marëdhënieve që krijohen në funksionimin e Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës

Problematika e tërësishme e objektit në fjalë me mjedisin trajtohet në kuadër të Ligjit mbi mbrojtjen e mjedisit.

Ecuria e analizës së problematikës së mbrojtjes së mjedisit në pajtim me këtë ligj është rregulluar edhe me rregulloren mbi analizën e ndikimit në mjedis (UA 09/2004 si dhe UA 07/2017).

Krahas parashtrimeve themelore nga rregullativat e sipërhënuara ligjore, për nevojat e hulumtimit konkret është shfrytëzuar edhe rregullativa tjetër ligjore, duke përfshirë ligjet në fuqi.

1

Hulumtimet në këtë lokalitet janë kryer me përkrahjen e vazhdueshme të investitorit të Kompanis NPT Ferplast si kompani investuese, dhe pas një studimi të hollësishëm dhe konkret janë bërë vizitat të terrenit në fjalë,

Pas kryerjes së punëve hulumtuese dhe marrjes së rezultateve nga studimi në terren është hartuar raporti vlerësimit i ndikimit në mjedis-VMN nga personi përgjegjës konform marrveshjes me kompaninë investuese. Hulumtimi (analizimi dhe studimi gjeomorfologjik) i terrenit ka qenë objektiva e këtij studimi, me konkretisht njohja më e mirë e strukturave litologjike dhe gjeokronologjike e gjeologjike që e ndërtojnë këtë hapësirë dhe zonë të hulumtuar, mandej marrja e të dhënave nga terreni me qëllim studimi më të kompletuar dhe hartimi të raportit VNM.

Hartimi i raportit vlerësimi i ndikimit në mjedis-VNM është pjesë përbërse e këtij studimi, ku janë përcaktuar detyrat bazë projektuese të dhëna nga investitori sipas qëllimit, vizionit dhe misionit.

Punimet në terren janë udhëhequr dhe mbikqyrur nga ekspert të ndërmarrjes kontraktuese gjegjësisht hartuesit e këtij raporti (VMN) në koordinim me investitorin.

Në mënyrë të hollësishme është bërë studimi mjedisor– kërkimor në mënyrë që të njihemi me përbërjen litologjike dhe të detajuar të kësaj pjesë të korës së tokës ose siq thuhet ndryshe ndyshimet litologo-gjeologjike (tektonika, forma, përbërja si dhe të dhënat tjera gjeologjike me të cilat kërkohet që të plotësohet studimi i hulumtimeve të terreneve kryesisht në fazën fillestare etj).

5.0. HULUMTIMI DHE POZITA E NGASTRËS SIPAS ZONËS KADASTRALE

Ngastra nr: P-72209079-00013-0, shtrihet në zonën industrial Ëzona kadastrale Babush i Serbëve në Ferizaj tani kjo zonë është e destinuar për zhvillime industriale

Përgjithësisht zona industrial planifikohet të jetë lokale dhe regjionale dhe do zhvillohen kryesisht ku tashmë është krijuar një bërtham e një zone industriale ose aty ku vërtet ekzistojn kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me PRRU dhe propozuar masat mjedisore. Duhet të trajtohen edhe ndikimet e industrive ndërtimore, Objekteve prodhuese dhe shërbyese , serviseve të ndryshme, etj.



Foto 1. Pamja e Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës , Objekti i planifikuar për ndërtim në kuadër të Kompanis NPT” Ferplast”



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Ferizaj


Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 913-0

Zona kadastrale / Katastarska zona: Babush Serbëve

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Objekt

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1600



Kordinatat e pikave të objektit		
Nr.	Y	X
1	7513334.633	4700930.578
2	7513329.655	4700952.862
3	7513325.575	4700972.84
4	7513401.237	4700989.74
5	7513412.331	4700947.933

Rilevoi / Snimio: Liridon Sejdiu
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime gjeodeta/ kompanije)

Rilevoi / Snimio: Valon Mehmeti
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime gjeodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 140

Nënshkrimi / Potpis: _____

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e rievimit / Datum sođmanja: 07.11.2023

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____




Fig.1. Pamja e planit të Situacionit , sipas kopjes së planit për ngastrën nr:000913-0




Foto.2. Babushi i Ri që është në zonën Kadastrale Babushi i Serbëve , është me një infrastruktur mjaft të zhvilluar , dhe gjendet me një distanc nga qendra e Ferizajt përkatësisht nga Objektet qendrore të NPT Ferplastit prej afro 7 km .

5.1. HISTORIK I SHKURT PËR KOMUNËN E FERIZAJT

Qyteti i Ferizajt, është i vendosur në jug të Kosovës, më saktësisht në anën e djathtë të autostradës Prishtinë-Shkup, 37 kilometra larg nga kryeqyteti Prishtina. Komuna e Ferizajt ka 345km², do të thotë vetë qytetit duke përfshirë edhe të tjera të dyzet e pesë 45 fshatrat rreth tij. Kjo zonë ka një popullsi prej 108,690 banorë, vetëm qyteti ka rreth 40000 banorë, kurse Zona e dytë e ferizajtit shtrihet në zonën kadastrale të Ferizajtit, Talinofcit të Muhagjerve dhe Jerlive dhe ka një sipërfaqe prej 223 ha. Ferizaj është relativisht një qytet i ri. Kjo komunë ka filluar të zhvillohet që nga viti 1873, kur hekurudha dhe stacioni hekurudhor janë ndërtuar. Në kohën e të folurit ka qenë një hotel, që ka ekzistuar dhe pronari i tij ishte Feriz Shashivari. Bazuar në emër të pronarëve Feriz Shashivari këtë qytet Ferizaj emrin e poseduar. Pas luftës ky qytet u shkatërrua relativisht. Sot krahasuar me qytetet e tjera ai është konsideruar si qyteti i dytë më i zhvilluar pas Prishtinës në Kosovë dhe është qyteti i tregut në Kosovë.

POZITA GJEOGRAFIKE




Fig.2. Harta konturale e komunës së Ferizajit , dhe pozita gjeografike e ferizajit në raport me Territorin e Republikës së Kosovës.

Me themelimin e autoritetit qendror për planifikim hapësinor, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) pas zgjedhjeve të para nacionale, kërkesa për plane të reja u shtua dukshëm. MMPH filloi reformën e sistemit të planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë,.



Foto.3. Pamja e një këndvështrimi të qytetit të Ferizajt

Zona e dytë e Ferizajit shtrihet në pjesën Verilindore të qytetit, përkatësisht në lartësi mbidetare 570-580.5 m. Kjo zonë është sipërfaqe e rrafshët me disnivel rreth 10 m, kurse pjerrtësia e terrenit është 1 deri në 2 % çka tregon se bëhet fjalë për një pjerrtësi shumë të vogël. Pjesa më e ngritur e konturës së kësaj zone është në zonën jugore, kurse zona qendër është një sipërfaqe shumë e rrafshët. Kjo vërehet shumë qart në prerjet tërthore të terrenit që do të japim më poshtë.

prerjet tërthore të terrenit që do të japim më poshtë.

me miratimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 të Kuvendit të Kosovës të datës 05 korrik 2003, të shpallur me 10 shtator 2003 nga ana e PSSP dha amendamentimin e këtij me hyrje në fuqi të Ligjit L 03/L 106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor.

Rëndësia e këtij akti, qëndron në detyrimet që ka Komuna, detyrohet që të hartoj Plane Zhvillimore përkatësisht Rregulluese Urbane dhe këtyre planeve të ju bëjë Vlerësimin Strategjik Mjedisor, duke aplikuar parimet ndërkombëtare të qeverisjes së mirë ndër të cilat gjithë përfshirja, transparenca dhe krijimi i ndjenjës së pronësisë së planit.

6.0. KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE, KLIMATERIKE, HIDROGJEOLOGJIKE, METEOREOLOGJIKE ,PEDOLOGJIKE DHE SEIZMIKE TË TERRENIT

61. GJEOMORFOLOGJIA – GJEOLOGJIA DHE TOKA

Në aspektin e gjeomorfologjisë zona e hulumtuar, përkatësisht zona industrial babush I Ri në zonënkadastrale Babush i Serbëve, Në përgjithësi karakterizohet me një relief relativisht të shohstë , në këtë pjesë kryesisht ka ndikuar faktori njeri duke u planifikuar kjo zonë në planifikimin e zhvillimit hapsinor dhe Urbanistik , përkthësaiahr në perspektivën e hartës zonale të Komunës së Ferizaj, format tipologjike dhe gjeomorfologjike dominojnë në pjesët periferike të ferizajt duke filluar nga malet e Jezercit.

Stabiliteti i terrenit në përgjithësi është stabile në veqanti për Ojektet me etazhitet më të ulëta . Natyrisht për ndërtimet në këtë zonë duhet t'i përshtaten edhe shkallës së aktivitet seizmik , poashtu në këtë zonë duhet të bëhen edhe analiza mikrosezimike për tërë zonën ku ndërtohet.

Toka në këtë zonë, dihet se është e klasit të mirë me çka, favorizon në masë të madhe zhvillimin e bimëve dhe të kopshteve, si dhe mundë të arrihet shumë shpejtë mbulesa vegetative e zonës. Sipërfaqja e tokës në këtë zonë, është mjaft e rrafshhtë, mirpor edhe me një pjerrtësi shumë të lehtë,nga ana jugore.

Në aspektin e Mborjtjes së Mjedisit, masat të cilat duhet të merren në këtë zonë, janë kontrollimi i materialeve të ndërtimit, të cilat mundë të sjellin ndotjene dheut. .

Kontrollimi i pesticideve, sidomos në zonat e parapara për kopshte, parqe dhe zona të gjelbërta dekorative, trajtimi i vendit ku qëndron deponia e mbeturinave inerte në zonën veriore para se të ketë zhvillime në te.

Ndërtimet, duhet të bëhen në atë mënyrë që, të kenë ndikim sa më të vogël në prishjen e strukturës së dheut. Dheu duhet që të ketë ajrosje dhe diellosje të mjaftueshme, në mënyrë që mos të ndikojë negativisht në botën e gjallë.

Duhet që të largohen nga kjo zonë të gjitha veprimtariët ndotëse, të cilat shkaktojnë ndotjene dheut.

Kosova ka një gjeologji të larmishme që varion në moshë nga neo-proterozoiku deri në holocen. Gjeologjia është e karakterizuar nga tipare substanciale strukturore në shkallë regjionale, duke përfshirë shkarjet (shkëputjet) normale dhe thyerjet. Një thjeshtim i përgjithshëm i sekuencës stratigrafike është si më poshtë.

Një thjeshtëzim i përgjithshëm i sekuencës stratigrafike paraqitet si vijon:

- Holoceni: depozitime shpatore të formuara nga alterimi i materialit shkëmbor nga viset malore dhe aluvionet e depozituara nga lumenjtë.
- Plioceni: silicor andezitik.

- Mioceni i Sipërm – Plioceni: formimi i linjtit nga akumulimi dhe më pas shpërbërja graduale e vegjetacionit në pellgjet sedimentare.
- Oligo-Mioceni: konglomerate, argjila dhe gëlqerorë, të shoqëruar nga magmatizmi acidik deri në mesatar.
- Molase të Kretakut të Vonshëm: karbonate të ujërave të cekëta dhe shkëmbinj klastik (copëzor).
- Flish i Kretakut të Sipërm: gëlqerorë mergelor, ranorë dhe konglomerate.
- Kretaku i Hershëm: konglomerate, ranorë dhe alevrolite.
- Jurasiku i Vonshëm: Gëlqerorë masiv.
- Triasik-Jurasik: magmatizmi bazik dhe acid, i shoqëruar nga riftimi i korës ofiolitike dhe obduksioni i shkëmbinjve ultrabazikë.
- Triasik: shkëmbinj klastik dhe vullkanikë që kanë mundësuar platformat karbonatike të shndërrohen në dolomite, disa prej të cilëve janë të metamorfizuara në mermer.
- Permo-Triasiku: shkëmbinjë karbonatik, klastik, filit, rreshpe(shiste) dhe kuarcite që janë vërshuar nga magmatizimi acid (kuarc porfirit).
- Palaeozoik i Vonshëm: **rreshpe.**¹
(Burimi ¹[https://kosovo-mining.org/resurset-minerale/gjeologjia/Gjeologjia e Kosovë](https://kosovo-mining.org/resurset-minerale/gjeologjia/Gjeologjia%20e%20Kosov%C3%AB)).

Formimi i përgjithshëm i zonës së gjerë të Projektit përfshin shkëmbinj të moshave të ndryshme: depozitime të Holocenit, Pleistocenit, Pliocenit, Kretaku dhe Jurasikut.

Shfrytëzimi i tokës bujqësore dominon me 15,626.5 hektarë, bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik dhe sektor që siguron më së shumti të hyra, sepse 2/3 e popullsisë jeton në zonat rurale. Sipas vlerësimit të tokës bujqësore, rezulton se 44.89 % e territorit është tokë bujqësore, 0.59 % djerrinë dhe 0.08 % kullosë/livadh.

Sipërfaqja e gjithmbarshme e tokave pyjore në komunë e Ferizajt është 14,343.27 ha, ku 64 % është pronë publike dhe 34 % është pronë private. Sa i përket shfrytëzimit të tokës së ndërtuar, dominon banimi individual me gjithsej 2498.18 ha, që përfshin edhe ndërtesat përcjellëse, bujqësore, deponuese apo garazhe. Në anën tjetër 0.41 % e territorit të komunës është e shfrytëzuar nga ujërat sipërfaqësor, përderisa sa i përket rrugëve 80 ha janë rrugë vendbanimi urban, 146.8 ha vendbanimesh rurale dhe 688 ha të tjerë, që nuk janë rrugë vendbanimore.

Një përqindje e ulët e sipërfaqes së tokës është shfrytëzuar për vijën hekurudhore që përshkon komunën. Janë gjithsej 44 ha, mbi të cilat shtrihet rrjeti hekurudhor, që kalon nëpër këto vendbanime: Varosh, Nikadin, Gurëz, Ferizaj, Bablak, Babush, Kosine, Lloshkobare dhe Prelezi Jerlive.

Sipas Plani Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt
Përdorimi i Tokës

Në komunë dominon shfrytëzimi bujqësor i tokës me 45.57% të territorit të përgjithshëm dhe pyjor me 41.82%, që paraqet një tregues shumë të rëndësishëm drejtë politikave zhvillimore ekonomike.

. Përdorimi I tokës në komunë Tabela e Ferizajt sipas (PZHK 2017 deri 2025).

6.2. KUSHTET KLIMATIKE

Zona klimatike e Kosovës (Rrafshi i Kosovës), që përfshin luginën e Ibrit është i ndikuar nga masa ajri kontinentale. Për këtë arsye në këtë pjesë të vendit dimrat janë më të ftohtë me temperatura mesatare mbi $-10\text{ }^{\circ}\text{C}$, por ndonjëherë nën $-26\text{ }^{\circ}\text{C}$. Verat janë shumë të nxehta, me temperaturë mesatare $20\text{ }^{\circ}\text{C}$, disa here mbi $37\text{ }^{\circ}\text{C}$. Kjo zonë është e karakterizuar nga një klimë të thatë dhe reshje vjetore totale afërsisht 600 mm në vit.

Kosova ka një klimë mesatare kontinentale, me ndikim dominues të klimës adriatiko-mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit përmes luginës së lumit të Drinit të Bardhë dhe me ndikim më të vogël të ndryshimit të klimës adriatiko-egjeane në fushën e Kosovës. Reshjet mesatare vjetore janë 596 mm .

Temperatura mesatare vjetore është $10\text{ }^{\circ}\text{C}$ (temperatura më e ulët është $-27\text{ }^{\circ}\text{C}$ dhe temperatura më e lartë është $39\text{ }^{\circ}\text{C}$). Bazuar nga kushtet klimatike, Kosova mund të ndahet në Zonën klimatike të Kosovës (Rrafshi i Kosovës), Zonën klimatike të Dukagjinit (Rrafshi i Dukagjinit) dhe Zonën klimatike të maleve dhe pjesëve të pyllëzuara.²

Zona klimatike e Dukagjinit (Rrafshi i Dukagjinit), që përfshin kurrizin ujëndarës të lumit Drini i Bardhë, është i ndikuar shumë nga masa ajri të nxehta, që përshkojnë Detin Adriatik. Temperaturat mesatare gjate dimrit luhaten nga $0.5\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në $22.8\text{ }^{\circ}\text{C}$.

Reshjet vjetore mesatare

të kësaj zone klimatike janë 700 mm për vit. Dimri është i karakterizuar nga reshje të forta dëbore.

Temperatura

Në komunën e Ferizajt temperatura mesatare vjetore është $10\text{ }^{\circ}\text{C}$, maksimumi ndodhë në Gusht me $37.3\text{ }^{\circ}\text{C}$, përderisa minimumi është në Janar në $-26\text{ }^{\circ}\text{C}$. Sasitë mesatare vjetore të reshjeve në Ferizaj sillen rreth 673.3 mm , përderisa muaji me më së shumti reshje është Maji, me 105.6 mm , ndërsa me më së paku muaji Gusht, me 42.2 mm . Mesatarisht toka e Ferizajt është 51.8 ditë e mbuluar me borë. Në Janar ka më së shumti borë (17.0 ditë), ndërsa më së paku borë ka Prilli (1.0 ditë).

Si rezultat i pozitës gjeografike

6.3. RESHJET ATMOSFERIKE

Si rezultat i pozitës gjeografike që ka Ferizaji dhe i ndryshimeve klimatike, respektivisht të temperaturave në gjithë globin tokësor, ka ndikuar që valorizimet klimatike në territorin e Ferizajt të jenë të ndryshme. Sipas të dhënave klimatike nga Instituti Hidrometeorologjik i

Kosovës, që nga viti 2002 e deri në vitin 2008, kemi rritje të temperaturave në gjithë regjionin e Gjilanit, dhe të Shtimes me Ferizaj, siç shihet nga tabelat në vijim.

Ferizaji, ndodhet në një lartësi 500 deri 600m mbi nivelin e detit. Në Ferizaj, dominon klima tipike kontinentale. Temperaturat mesatare, është 9.9°C dhe temperaturat më të ulëta, shkojnë deri në 8°C, kurse temperaturat ekstreme shkojnë deri në 22°C, por që nuk zgjasin shumë deri në tri ditë. Temperaturat maksimale, shkojnë deri në 27°C, kurse temperaturat ekstremet shkojnë deri në 36°C.

Gjatë ndërtimeve, duhet pas parasysh përzgjedhjen e materialeve të ndërtimit të cilat ndikojnë në ngritjen e temperaturave dhe ashpërsimin e mikroklimës urbane, po ashtu, duhet të bëhet përzgjedhje e mbulesës vegjetative e përshtatshme, dhe llojet stabile për mjedisin urban të Ferizajit..

Nga të dhënat të cilat janë marr nga hulumtimet në terren për ndotje mjedisore del se kemi të bëjmë me ndotje kryesisht nga komunikacioni si ndotja akustike - zhurma dhe ndotjet nga emitimi I gazrave nga komunikacioni rrugor , që tani është mjaft I zhvilluar infrastruktura rrugore .




Fig. 4. Pamja e histogramit të reshurave atmosferike , maksimumet mesatare dhe temperature mesatare dhe thatësira.

Thatësira

Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

6.4. HIDROGJEOLGJIA DHE HIDROLOGJIA

Lokacioni i hulumtar Babushi i Ri, në aspektin e pasurisë së ujërave nëntoksore është mjaftë i pasur me ujërat nëntokosore që mundë të kenë gjenezë si burime të ujërave nëntoksore si burime Piezometrike , dhe në pjesën periferiketë Ferizajt , janë burimet tjera të ujërave nëntoksore , disa nga to mundë të arrijnë edhe të burojnë dhe të transformohen nga ujërat nëntoksore në ujërat sipërfaqësore .

6.4.1. Hidrologjia

Në Kosovë ka shumë lumenj që rrjedhin drejt Detit Adriatik, Detit të Zi dhe Detit Egje. Lumenjtë kryesorë të Kosovës janë Drini i Bardhë (në pjesën jugore të Kosovës - derdhet në detin Adriatik), Lumi Ibër (në pjesën veriperëndimore derdhet në lumenjtë Morava dhe Danub dhe më tej në Detin e Zi), Lumi Lepenc (në pjesën juglindore derdhet në lumin Vardar dhe në detin Egje). Lumenjtë tjerë të rëndësishëm në Kosovë janë: Lumi Sitnica, Morava e Binçës, Bistrica e Pejës dhe Bistrica e Deçanit. Kosova gjithashtu ka një numër të madh të burimeve karstike, burimeve të ujërave termale dhe minerale, luginave akullnajore dhe liqeneve natyrore dhe artificiale.² (2 <https://vv.vv.vv.Kosovo-mining.org/kosova/hidrologjia/>)

Nëpër territorin e komunës së Ferizajt rrjedhin lumenj dhe përrenj të shumtë. Lumi kryesor është ai i Nerodimes, i cili kalon edhe nëpër qytetin e Ferizajt. Ky lum është i mbuluar brenda qytetit.

Hidrografinë e këtij lumi e përbëjnë 13 përrenj. Lartësia mbidetare e lumit në Ferizaj është 580 m. Komuna e Ferizajt ka ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore.

6.5.. KARAKTERISITIKAT PEDOLOGJIKE , NATYRA DHE BIODIVERSITETI , FLORA DHE FAUNA

Në afërsi të lokacionit Babushi i Ri , konkretisht në ngastrën nr 000913-0, nuk ekzistojnë toka bujqësore tani më pasi e tërë ajo sipërfaqe bujqësore që ishte tani ka ndryshuar destinimin nga toka bujqësore në troje për biznes dhe zhvillim i industrial si dhe për aktivitet tjera afariste **Natyrë dhe Biodiversiteti** –Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokalitet kemi të bëjmë me ndikimet në ndonji hapësirë të mbrojtur me ligjë në drejtim të biodiversitetit si dhe në ruajtjen e bimëve enedemike në përgjithësi , në përgjithësi në këtë zonë industriale dhe komerciale nuk gjenden bimësi ngastra me potencial vegjetativ të pasur me bimët endemike.

Flora dhe Fauna –

Shikuar nga aspekti historik i zhvillimeve që kanë ndodhë në zonë, kjo zonë në të kaluarën ka qenë mjaft e pasur me lloje të ndryshme bimore dhe shtazore sidomos të shpezëve zvarranikëve dhe ujëtokësorëve pasi që siç dihet se kjo zonë ka qenë zonë moqalore. Zhvillimet e më vonshme tregojnë se këtu pastaj kemi shtrirjen e vendbanimit

Zhvillimi i hovshëm i teknologjis konkretisht faktori njeriut e që drejt për drejt faktori antropogjen ka qenë kryesori në shkatërrimin e habitateve të ndryshme të llojeve bimore dhe shtzore. Aktualisht në ë zonë më periferike te qytetit të Ferizajt ndodhen disa sosh-individ të shelgjeve (*Salix. sp.*) dhe disa individ të plepit (*Populus tremula*) që duket se janë tregues të një vegjetacioni të tillë në të kaluarën. Këtu haset edhe kallamishtja, disa individë të kulumrisë, Blirit (*Tilia argentea*), të cilat janë sjellë në mënyrë aksidentale ose të qëllimshme




Fig.5. Harta sipas pozitës gjeografike të Ferizajt në raport në Hartën Kosovës

nga faktori njeri, si dhe shumë lloje të kultivuara të bimëve dekorative, frutore të cilat gjenden nëpër kopshte dhe përgjatë rrugëve.

Sa i përket shtazëve në këtë zonë tani kemi vetëm disa lloje të shpezëve që për çdo ditë po ju ngushtohet areali i tyre si laraska, sorra e rëndomt, trumcakët, pllumbat dhe kumriat, nga herpetofauna kemi prezent bretosat si (Rana esculenta, Bufo bufo dhe picrraket), nga insektet kemi disa lloje të fluturave, miza e shtëpis grenjza dhe lloje të ndryshme të mushkonjave, nga gjitarët në këtë zonë tani kemi minjët lakuriqëve kunadhen dhe qelbsin dhe qenët shtëpiak.

6.6. KRITERET SEIZMIKE

- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionet e planifikuara gjatë ndërtimit të Parkut Solar.

8.0. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Ky kapitull identifikon dhe vlerëson ndikimet e mundshme mjedisore të projektit të propozuar të Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës në mjedisin fizik, social dhe njerëzor brenda zonës së ndikimit të projektit të propozuar. Ndikimet e mundshme janë vlerësuar për të gjitha aktivitetet që nga faza e ndërtimit si dhe mbarvajtja e prodhimit pa ndikuar negativisht në mjedis.

8.1 Ndikimet në cilësinë e ajrit

Gjatë funksionimit të projektit nuk pritet asnjë ndotje të ajrit që mund të mbulojë një sipërfaqe të madhe të popullsisë vendase, florës dhe faunës, tokës dhe nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në cilësinë e ujit. Megjithatë, gjatë ndërtimit të Objektivit të lartë cekur, mundë të keët simbolikisht

ndotje nga pluhuri nëse është koha me diell i shfaqur për shkak të përdorimit të makinerive mund të ndotin mjedisin.

Gjatë aktiviteteve të ndërtimit do të gjenerohet pluhur dhe gazra të djegies nga makineritë dhe automjetet me karburant përgjatë zonës së ndërtimit (ndotësit e ajrit dhe grimcave përfshijnë kryesisht: PM10, PM2.5, CO2, NOx dhe SO2).

Emetimet nga këto aktivitete mund të shkaktojnë ndikime të drejtpërdrejta në cilësinë e ajrit dhe ndikim indirekt tek njerëzit lokalë nga vendbanimet në zonën e projektit, veçanërisht tek banorët vendas që jetojnë pranë zonës së projektit, përdoruesit e rrugëve lokale, punëtorët, fermerët,

Ndërsa gjatë fazës së operimit nuk do të ketë ndikime negative në cilësinë e ajrit, pasi që nuk do të ketë emetime të mëdha. Zhvillimi i propozuar përfaqëson një investim në infrastrukturën e energjisë së pastër dhe të rinovueshme, e cila, duke pasur parasysh sfidat e krijuara nga ndryshimet klimatike, përfaqëson një përfitim social pozitiv për shoqërinë. Si emetim të vetëm gjatë fazës së operimit mund të përmendim automjetet që janë aktiv derisa të përfundojë ndërtimi I Objektivit të lartë cekur, po shpesh mjetet transportuese perseri do të jenë present në Oborrin ekonomik të Fabrikës për prodhimin e tubave nga plastika, megjithatë nuk do të tejkalojnë përqëndrimin maksimal të lejuar të emisionit ndotës në ajr nga trafiku rrugor .

8.1.1 Masat për mbrojtjen e ajrit

Projekti nuk ka ndikim të vazhdueshmë në cilësinë e ajrit. Gjatë punës me makina ngarkuese dhe transportuese të gjitha sipërfaqet manipuluese të spërkatën me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta. Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese dhe transportuese që konsumojnë lëndë djegëse të lëngëta fluid me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jenë sa më kualitative. Do të përdoren automjete dhe kamionë specialë për transportin e pajisjeve të paneleve edhe materialeve të ndërtimit dhe rrugët e shtruara me zhavorr do të spërkatën me ujë në mënyrë të rregullt. Rrugët që nuk përdoren më do të mbyllën pas kryerjes së punimeve

rehabilituese. Gjithashtu, në zonat e banuara shpejtësia e automjeteve duhet të kufizohet në 30 km/orë.

8.2 Ndikimet në tokë

Gjatë fazës së ndërtimit nuk do të ketë ndikime të dukshme në ndërtimin e konfiguracionit të mbulesës argjilore për sa i përket ndryshimeve gjeologjike pasi që punimet që do të kryhen në Objektivin e lartë cekur nuk mund të ketë ndryshime në relief apo në përbërjen argjilore do të jenë punime që kryesisht kryhen mbi tokë me një etazh apo Etazhitet të ultë..

Në përgjithësi, mund të ketë dëmtim të cilësisë së tokës (ndotje të tokës) për shkak të lirimit të ndotësve gjatë punimeve. Punimet do të sjellin rritje të trafikut të automjeteve, makinerive dhe mund të ndodhin rrjedhje të paqëllimshme të vajit dhe lubrifikantëve të quajtura aksidente ekologjike . Zonat e magazinimit të materialeve të rrezikshme mund të shkaktojnë efekte edhe më serioze; mirëpo me organizim adekuat të ruajtjes së materialeve të rrezikshme, impakti cilesohet si minimal. Kontraktori duhet të sigurojë që mos të ketë asnjë derdhje nafte nga

automjetet dhe makineritë e tyre. Në rast të derdhjeve aksidentale, kontraktori duhet të marrë të gjitha masat emergjente për të pastruar siç duhet vendndodhjen e rastit aksidental dhe mbetjet duhet të depozitohen dhe transportohen siç duhet në vendet e caktuara. Në çdo rast, duhet të merren masa specifike në mënyrë që të sigurohen ndotjet e papritura gjatë ndërtimit.

- Ndërtimin e rrugëve: Ndërtimi i rrugëve dhe pikave të hyrjes në Fabrikën për prodhimin e tubave të plastikës nëse nuk menaxhohet siç duhet, pasi mund të çojë në krijimin e gropave dhe grykave që mund të kanalizojnë ujin dhe të gërryejnë tokën.
- Kullimin: Drenazhimi i dobët mund të çojë në erozion, pasi uji mund të grumbullohet dhe të gërryejë tokën, veçanërisht gjatë reshjeve të mëdha, dhe gjithashtu mund të dëmtojë panelet dhe sistemin.

Instalimi i kablllove do të bëhet në thellësi të caktuar të tokës. Instalimi i kablllove nën tokë shoqërohet me potencialin për rreziqe mjedisore të konsiderueshme. Këto rreziqe përfshijnë ndikimin në biodiversitet, ndikimin në ekosistemin e ujërave nëntokësore, , si dhe rrezikun e shpërthimit dhe kontaminimit të tokës.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet në tokë janë të papërfillshme.

8.2.1 Masat për mbrojtjen e tokës

Masat për parandalimin e ndotjes së tokës do të jenë pjesë e planeve të mëposhtme që do të zhvillohen nga Kontraktori:

- (i) Programi i Menaxhimit të Sigurt të Materialeve të Rrezikshme dhe Parandalimit të Derdhjeve, dhe
- (ii) Plani i Menaxhimit të Mbetjeve. Disa nga masat që mund ti përmendim për mbrojtjen e tokës janë:
 - Planifikimi paraprak i punës dhe realizimi i operacioneve në kohën më të shkurtër të mundshme. Kontroll dhe kolaudim periodik i gjendjes teknike të makinerive;
 - Lëndet ndihmese si karburanti dhe vajrat lubrifikues (te cilat janë të nevojshme për shërbime servisi të makinerive) të vendosen në ambiente të sigurta në zonën e projektit;
 - Në rast të ndotjes aksidentale të tokës, duhet të hiqet dhe i ndotur dhe të ruhet në kontenierë të izoluar për t'u trajtuar më pas në vendin dhe mënyrën e përshtatshme;
 - Të gjitha mbeturinat e krijuara duhet të mblidhen dhe të vendosen jashtë punishtës ku vendosen Fabrika për prodhimin e tubave të plastikës kurse me ato mbeturina të veprohet sipas rregullave të ligjit të mbeturinave Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina;
 - Planifikimi i kujdesshëm dhe respektimi i ligjeve dhe rregulloreve mjedisore për sigurinë dhe ruajtjen e mjedisit gjatë punës së instalimit të kablllove në thellësi të tokës.

8.3. Ndikimet në mjedisin ujq

Në këtë zonë nuk gjenden ujërat sipërfaqësore dhe dhe trupa ujqorë që mund të preken nga ndërtimi i këtij projekti. Punët e ndërtimit për Fabrikës për prodhimin e tubave nga plastika nuk ndikojnë në burimet ujqore të së gjithë zonës së projektit.

Trupat ujqorë sipërfaqësorë janë të ndjeshëm ndaj ndotjes. Karakteristikat e cilësisë dhe karakteristikave të ujqit (niveli dhe vëllimi) mund të ndryshojnë si rezultat i aktiviteteve të projektit. Gjatë fazës së ndërtimit, burime kryesore të gjenerimit të ujqërave të ndotura janë rrjedhja e ujqërave të shiut nga kantieret e ndërtimit; ujqërat e zeza të krijuara nga kampet e punëtorëve të ndërtimit si dhe ujqërat e zeza të aktiviteteve të ndërtimit.

Mbetjet solide të pezulluara mund të largohen tutje nga rrjedhja e ujqit të reshjeve nga vendi i ndërtimit pa bimësi ose lëshuar aksidentalisht gjatë aktiviteteve të ndërtimit, hedhjes së mbeturinave ose pastrimit të pajisjeve. Lirimi i vëllimeve të konsiderueshme të sedimenteve në ujqëra nga rrjedhja e ujqit të stuhisë ose largimi i drejtpërdrejtë, mund të çojë në ndryshime të rrjedhës së ujqit.

Vajrat lubrifikuese, bojrat, tretësit, rrëshirat ose acidet, të cilat lëshohen nga rrjedhjet aksidentale, derdhjet nga makineritë dhe vendet e deponimit të materialeve, mund të shkaktojnë ndotjen e ujqit. Ndotja e trupit ujqorë mund të ndodhë drejtpërsëdrejti (p.sh. nëse vendpunishtja e ndodhet shumë afër lumit ose në lumë) ose në mënyrë indirekte, përmes transportit të tokësor dhe ujqërave nëntokësore në trupin ujqor sipërfaqësor.

8.3.1 Masat për mbrojtjen e ujqit

Duke qenë se zona e projektit nuk ndodhet në afërsi të konsiderueshme me ndonjë mjedis ujqor (liqe, lumenjë, etj) nuk parashihet të ketë ndikim, mirëpo miratimi i praktikave të mira të ndërtimit dhe menaxhimi i zonës së ndërtimit do të shmangë ndikimin potencial në hidrologjinë e zonës së projektit.

Higjiena e përshtatshme mjedisore, së bashku me praktikat e mira të ndërtimit dhe menaxhimit të kantierit duhet të sigurohet nga Kontraktori për të siguruar që mbeturinat, lëndët djegëse dhe tretësit të mos hyjnë në rrjedhat e afërta ujqore. Gjithashtu, gjatë fazës së operimit, Projekti është një konsumator potencialisht i rëndësishëm i ujqit për shkak të larjes së paneleve diellore. Ujqërat e zeza nga larja e moduleve FV duhet të dërgohen në një impiant për trajtimin e ujqërave të zeza ose të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit. Ujqërat e ndotura duhet të trajtohen dhe vetitë e tyre do të monitorohen për t'u siguruar që ato përmbushin standardet kombëtare të vendosura përpara shkarkimit.




Fig.8. Skema e trajtimit të ujërva të drenazuara nga Oborri i fabrikës NPT Ferplast

8.4 Ndikimet nga Mbetjet

Aktivitetet ndërtimore, pastrimi i mbetjeve ekzistuese, punimet tokësore, saldimi, përdorimi i makinerive si dhe prania e punëtorëve do të jenë burim i llojeve të ndryshme të mbetjeve si: mbetjet inerte, mbeturinat komunale, mbetjet e biodegradueshme, mbetjet e ambalazheve, mbetjet e rrezikshme etj. Menaxhimi jo i duhur i mbetjeve mund të shkaktojë ndikim negativ në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Gjatë aktiviteteve ndërtimore Fabrikës për prodhimin e tubave nga plastika , në zonën e ndërtimit gjithashtu pritet të transportohen dhe përdoren kimikatet dhe materialet e rrezikshme si p.sh: lëndë djegëse, lubrifikantë, antifriz, gazra të ndezshëm, veshje asfalti, plastifikues, materiale izoluese, bojëra, etj. Transporti, magazinimi dhe trajtimi i papërshtatshëm me materiale të rrezikshme mund të shkaktojë ndikim negativ në mjedis, shëndetin dhe sigurinë e komunitetit dhe të punëtorëve.

Ndërsa gjatë fazës së operimit të Fabrikës për prodhimin e tubave nga plastika , funksionimi dhe mirëmbajtja do të gjenerojë mbetje të menaxhuara dhe që riciklohen në tërësi përsëri për procesin teknologjik, kurse mbetjet tjera I mirmban Kompanija Pastrimi .

8.4.1 Masat mbrojtëse për mbetjet

Disa nga masat për zbutjen e mbetjeve do të jenë:

- (i) Përgatitja e një plani për menaxhimin e mbetjeve të ngurta;
- ii) Ndarja dhe magazinimi i mbetjeve duke respektuar shëndetin dhe mjedisin. Identifikimi i çdo mbeturine që mund të ripërdoret ose riciklohet dhe
- (iii) Ruajtja e të gjitha mbetjeve të depozituara në depo të sigurta brenda kantierëve të ndërtimit, duke shmangur mbeturinat dhe rrjedhjet si dhe deponimin në deponi të alokuara nga komuna.

8.5 Ndikimet në Peizazh

Ndikimet e parashikuara në peizazh do të lindin nga prania e elementëve të reja që do të ndryshojnë përkohësisht peizazhin për shkak të natyrës së punimeve ndërtimore. Ndryshimet e përkohshme në përgjithësi do të lidhen me praninë e punëtorëve, makinerive të rënda, s'forcimin e oborrit ekonomik të Fabrikës për prodhimin e tubave të plastikës , deponimet e materialit ndërtimor, grumbujt e mbeturinave, inerteve gjate periodes se ndertimit te Fabrikës Ferplast etj., të cilat do të dëmtojnë peizazhin lokal, veçanërisht për banorët aty pranë. Receptorët e mundshëm të peizazhit në rajon përfshijnë banorët vendas, udhëtarët dhe turistët. Gjatë fazës së ndërtimit, peizazhi përgjatë zonës së projektit do të shndërrohet eventalisht në një peizazh të një zone ndërtimi. Megjithatë ky ndikim do të jetë i përkohshëm deri në përfundimin e aktivitetëve ndërtimore.

8.5.1 Masat për mbrojtjen e peizazhit

Gjatë aktivitetëve të ndërtimit, ndikimi në peizazh mund të zbutet duke përdorur teknika për të mbuluar operacionet e punëtorëve në vendin e ndërtimit dhe zonave ndihmëse. Për këtë, mburoja mund të instalohen rreth perimetrit të zonës së ndërtimit.

8.6 Ndikimet nga zhurma

Ka disa aktivitete që gjenerojnë zhurmë, si hapja e rrugëve të hyrjes në kantier dhe objektet e personelit të ndërtimit (nëse është e nevojshme), punimet tokësore, aktivitetet e transportit, mbushja dhe instalimi i paneleve fotovoltaike, dhe pajisje të tjera brenda objektit, përveç burimeve të zhurmës që gjenerohen nga makineritë dhe pajisjet në vend.

Rritja e niveleve të zhurmës mund të prekë banorët lokalë që jetojnë pranë vendndodhjes ku do të kryhen aktivitetet ndërtimore, gjurmës së rrugëve, kafshëve shtëpiake, faunës ekzistuese të të gjithë zonës së projektit dhe punëtorëve të angazhuar. Për shkak të rritjes së nivelit të zhurmës, disa kafshë dhe zogj mund të largohen (përkohësisht) nga habitatet e tyre. Megjithatë, zhurma gjatë ndërtimit është një shqetësim i natyrës së përkohshme (afatshkurtër), kështu që ndikimet nuk janë të mëdha, përveç në afërsi të zonës së ndërtimit. Vlen të theksohet që përmes territorit të zonës së Projektit kalon rruga Magjistrale Prishtinë-Ferizaj, që do të thotë se zona e projektit është një zonë e ndikuar nga zhurma edhe pa praninë e Projektit.

. Pajisjet që emitojnë zhurmë duhet të jenë në përputhje me standardet e zbatueshme të zhurmës së BE-së për këto pajisje siç përshkruhet në Direktivën e BE-së Nr. 2000/14/KE të Parlamentit

Evropian dhe Këshillit të 8 majit 2000, për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare, në lidhje me emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim të jashtëm. Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në zonë, ndërkohë që në zonat e ndjeshme, mund të aplikohen masa mbrojtëse ndaj zhurmave.

8.6.1 Masat mbrojtëse për zhurmën

Emetimi i zhurmës nga aktivitetet e ndërtimit do të reduktohet dhe parandalohet duke përdorur pajisje të përshtatshme të reduktimit të zhurmës dhe në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-102 për mbrojtje nga zhurma. Automjetet që janë tepër të zhurmshme për shkak të mos funksionimit të mirë, dëmtimit të pajisjeve për përmirësimin e zhurmës ose kushteve të tjera joefikase të funksionimit, nuk duhet të përdoren derisa të merren masa korigjuese. Ndikimet e zhurmës që lidhen me ndërtimin janë të përkohshme dhe mund të zbuten përmes një praktike të mirë ndërtimi dhe mbikëqyrjes efektive të zonës së ndërtimit.

zhurma e krijuar nuk do të dëgjohet në pranues të ndjeshëm, nivele të ulëta zhurme do të gjenerohen gjatë aktiviteteve rutinë të mirëmbajtjes. Niveli më i lartë i zhurmës do të jetë nga lëvizjet e përditshme të automjeteve. Ky ndikim do të lokalizohet brenda zonës dhe ashpërsia/niveli i rrezikut të ndikimit konsiderohet të jetë i ulët.

8.7 Ndikimet në Biodiversitet

Prania e punëtorëve, niveli i rritur i zhurmës, lëvizja e makinerive, furnizimi i lëndëve të para, gjenerimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza, magazinimi dhe trajtimi i materialeve mund të shkaktojë degradim dhe transformim të habitateve, si p.sh humbje të florës, fragmentimi të habitateve, humbje të specieve (dëmtim) ose shqetësimi dhe/ose zhvendosje të specieve të faunës si: zvarranikët, amfibët, gjitarët e vegjël dhe shpendët gjatë periudhës së shumimit, etj.

Një pjesë e aktiviteteve të projektit mund të prekin gjitarët e vegjël, zvarranikët dhe mund të rrezikojnë ata. Aktivitetet ndërtimore mund të paraqesin një rrezik zjarri (gjatë saldimit ose për shkak të neglizhencës njerëzore) për habitatet, gjatë muajve më të thatë të verës. Mirëpo duke qenë se projekti kryhet në zonën me biodiversitet të ulët dhe me masat e propozuara zbutëse, ndikimet konsiderohen të papërfillshme dhe ndodhin vetëm brenda zonës së projektit.

8.7.1 Masat mbrojtëse për biodiversitetin

Për të minimizuar dëmtimin e faunës në zonë, sugjerohen një kombinim masash. Konkretisht, Kontraktorit do t'i kërkohet të:

- Minimizojë humbjen e gjelbërimit nga aktivitetet e ndërtimit dhe të kufizojë sipërfaqen e lëvizjes në minimum;
- Parandalojë gjuetinë dhe grumbullimin vezëve nga punëtorët e ndërtimit;
- Minimizojë dëmtimin të rrjedhave ujore nga punimet tokësore dhe të bëhet depozitimi i papërshtatshëm i mbetjeve.

8.8. Ndikimet e mundshme Sociale

8.8.1 Kushtet e Punës

Aktivitetet ndërtimore do të gjenerojnë një sërë mundësish pune për banorët vendas, por nëse masat adekuate nuk zbatohen gjatë përzgjedhjes së fuqisë punëtore (përzgjedhja e kualifikuar e gabkontraktorëve, person i kualifikuar nga Kontraktori) ekziston rreziku i shfaqjes së ndikimeve negative socio-ekonomike që lidhen me humbjen e tokës dhe pronave. Përveç dëmeve të mundshme që mund të shkaktohen nga punëtorët e pakualifikuar, ata duhet t'i nënshtrohen trajnimeve në mënyrë që të përmbushin standardet ndërkombëtare për punëtorët. Zbatimi i projektit mund të shkaktojë abuzim të personave të cënueshëm dhe fëmijëve nëse ata përdoren për punë, por këto raste nuk do të tolerohen.

Si rezultat i aktiviteteve të ndërtimore ekziston mundësia e ndikimit negativ të punëtorët si rezultat i: stresit të shkaktuar nga mjedisi i punës i lidhur me zhurmën, shëndeti i rrezikuar i punëtorëve për shkak të përdorimit të pajisjeve rrotulluese dhe lëvizëse, stresi i shkaktuar nga mjedisi i punës i lidhur me gazrat e shkarkuara, shëndeti i rrezikuar i punëtorëve nga zjarri dhe shpërthimi etj.

Për ti evituar këto probleme, kontraktori do të duhet të sigurojë ambiente të sigurta të punës që do të jenë në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret ndërkombëtare dhe kombëtare.

8.8.2 Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit

Gjatë aktiviteteve të ndërtimore, në territorin e gjithë zonës së ndërtimit, shëndeti dhe siguria e komunitetit mund të rrezikohet si rezultat i ekzistencës së kantierëve aktiv të ndërtimit të cilët do të vendosen në zonën e projektit.

Rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit lidhen me: kantieret e ndërtimit dhe kampet për punëtorët; prania e punëtorëve dhe sjellja e punëtorëve ndaj mjedisit dhe banorëve lokalë; rritja e vëllimit të trafikut nëpër vendbanime; shqetësimet nga pluhuri i krijuar, zhurma dhe dridhjet; ndotjet e mundshme të ujit dhe tokës; ndërprerja e rrjedhjes së jetës së përditshme, e shkaktuar nga akseset e kufizuara në vendbanime, toka dhe prona; ndikimet e mundshme në asetet materiale (tokë bujqësore, infrastrukturë të ndërtuar-rrugë, ujësjellës, kanalizime, shpërndarje të energjisë elektrike, etj.) në zonën e projektit.

Qasja e paligjshme e njerëzve dhe bagëtive në zonën e ndërtimit mund të rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e tyre, si dhe shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve të përfshirë në procesin e ndërtimit. Rritja e intensitetit dhe vëllimit të trafikut mund të ndikojë në regjimin normal të trafikut në zonën e projektit. Përveç kësaj, aktivitetet ndërtimore mund të shkaktojnë shqetësim gjatë periudhave festash fetare dhe praktikave për popullatën vendase dhe kjo mund të nënkuptojnë mungesë respekti për vlerat e tyre.

Prandaj duhet marrë një sërë masash të sigurisë dhe shëndetit të punës në zonën e ndërtimit, të cilat do të aplikohen gjatë aktiviteteve të ndërtimit. Masat bazohen në vendndodhjen specifike të ndërtimit të Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës . Masat e rekomanduara gjatë organizimit të ndërtimit të paneleve fotovoltaike janë:

- Brenda strukturës organizative të kantierit do të caktohet personeli që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin gjatë kryerjes së punëve;
- Kohëzgjatja e kufizuar e orarit të punës dhe periodhat e përcaktuara të pushimit gjatë ditës;
- Hartimi dhe zbatimi i skemës e cila përcakton kantierin që krijon kushtet për kryerjen e sigurt dhe të shëndetshme të punëve;
- Përzgjedhja e materialit, teknologjisë dhe mekanizimit për punë personale me ndikim minimal të zhurmës, pluhurit, dridhjeve, gazrave nga makineritë e punës, zjarri, etj. në këtë rast shpesh rekomandohet:
 - Spërkatja e rrugëve të përkohshme të kantierit;
 - Materialet e nevojshme për kryerjen e punimeve të depozitohen dhe ruhen në vende të zgjedhura për këtë qëllim;
- Përdorimi i makinerive dhe pajisjeve që shkaktojnë më pak zhurmë;
- Mirëmbajtja e duhur e makinave dhe kontrolli i tyre në kohë në hapësirën e caktuar për atë qëllim;
- Gjatë ndërprerjes së punës për një kohë më të gjatë, mekanizmat dhe pajisjet do të largohen në një vend të sigurtë;
- Vendosja e strukturave mbrojtëse si: gardhe, streha dhe mbrojtja e rrethojave;
- Zgjedhja e një sistemi të përshtatshëm të mbrojtjes nga zjarri si për makineritë ashtu edhe për kantierin në tërësi;
- Shënimi i shenjave përkatëse të sigurisë në afërsi të kryerjes së punimeve.

Për shkak të mbrojtjes personale dhe shëndetit, punëtorët do të jenë të detyruar të përdorin pajisje mbrojtëse personale duke përfshirë mjete dhe pajisje për mbrojtjen e kokës dhe trupit, mjetet dhe pajisjet mbrojtëse për punët në lartësi si dhe masa tjera sipas nevojës.

8.8.3 Trashëgimia Kulturore

Komuna e Ferizajit ka një trashëgimi të pasur kulturore, megjithatë, ato nuk janë në afërsi dhe nuk do të ndikohen nga zbatimi i projektit. Duke pasur parasysh se zona e projektit tani është sipas statusit si zonë industriale e quajtur Babush i Ri , gjatë punimeve , ka gjasa të vogla , megjithatë është e mundur të zbulohet një vend i panjohur arkeologjik.

Nëse zbulohen objekte arkeologjike ose fetare (gjetje të rastësishme mirpo të vlefshme dhe më rëndësi në të gjitha aspektet kulturore, religjioze , artifakte , relikte te vendburimeve metalore etj (atëherë duhet të njoftohet menjëherë Shërbimi Arkeologjik i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Kulturës (brenda 24 orëve).

8.9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM) përgatitet për të menaxhuar ndikimet mjedisore nëpërmjet veprimeve specifike zbutëse që kërkohen për zbatimin e projektit në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregulloreve kombëtare në fuqi. Plani i Menaxhimit Mjedisor ofron një përmbledhje të kushteve bazë mjedisore në zonën propozuar të projektit, përmbledh ndikimet e mundshme që lidhen me punimet e propozuara të ndërtimit dhe përcakton masat e menaxhimit të kërkuara për të zbutur çdo ndikim të mundshëm.

Ky PMM do të zbatohet nga kontraktori që do të autorizohet nga MMPHI për projektin. Objektivat e PMM janë:

- Minimizimi i çdo ndikimi negativ mjedisor, social dhe shëndetësor që rezulton nga aktivitetet e projektit;
- Parandalimi ose kompensimi i çdo humbje të personave të prekur nga projekti;
- Kryerja e të gjitha aktiviteteve të projektit në përputhje me ligjet përkatëse të Kosovës;
- Rritja e rezultateve pozitive mjedisore dhe sociale;
- Të sigurohet që PMM është i realizueshëm dhe me kosto efektive;
- Të veprojë si një plan veprimi për të siguruar që masat për zbutjen e ndikimit të projektit janë zbatuar dhe monitoruar siç duhet; dhe
- Siguron që të gjitha shqetësimet e palëve të interesuara të adresohen.

Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të shkurtër të ndikimeve në mjedis dhe rekomandon masa zbutëse në përputhje me ato që u thanë në pjesët e mëparshme të këtij raporti. Gjithashtu, rekomandohet në tabelë delegimi i përgjegjësive për zbatimin e masave përkatëse për palët përkatëse të projektit.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, mbështetet në parimet e bashkëpunimit, qëndrueshmërisë, integritit, ndotësi-paguan, edukimin dhe shkollimin, përgjegjësinë dhe menaxhimin efektiv për ruajtjen e natyrës

dhe kushteve ekzistuese do të përcaktohen në këtë kapitull. Zona e studimit është në kuadër të komunës së Ferizajit. Kushtet bazë për burimet kryesore mjedisore janë analizuar dhe paraqitur për

të përshkruar burimet e rëndësishme mjedisore dhe ndjeshmërinë e tyre në lidhje me zonën e projektit.




Fig.9. Pozicioni Gjeografik dhe Topografia e Komunës së Ferizajt

Territori i komunës së Ferizajt zë një sipërfaqe prej 344.64 km², që shtrihet në jug të pjesës qendrore të Kosovës. Paraqet një udhëkryq të rëndësishëm, sepse nëpër Ferizaj kalojnë të gjitha rrugët e rëndësishme që e përshkojnë Kosovën nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Këto rrugë pastaj vazhdojnë edhe në shtetet fqinje dhe në rajon. Në lindje kufizohet me komunën e Gjiilanit dhe të Vitisë, nga të cilat qendra ka distancën rrugore prej 32, përkatësisht 21 km. Në jug

kufizohet me komunën e Kaçanikut (16 km), në jugpërendim me Shtërpçën (32 km), në përendim me Prizrenin (60 km) e Therandën (42 km) dhe në veri me Shtimen (13 km) e Lipjanin (17 km). Distanca e Ferizajt nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina, është 36 km, kurse nga Shkupi 48 km. Lidhjet ajrore për Ferizajin . realizohen përmes aeroportit të Prishtinës që është në largësi prej 33 km. Distanca rrugore FerizajTiranë është 350 km, kurse me portin e Durrësit 384 km.1

Lokacioni i Objektivit për prodhimin e tubave të plastikës është në Komunën e Ferizajt, me koordinatat 42°20'17.901" V,

21°11'52.15" L.

8.9.1.. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS TË NJË PROJEKTI

- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.
- Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin, pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si

8.9.2. ELEMENTET BAZË PROGRAMORE - METODOLOGJIA E PUNËS

Metodologjia e punës sipas të cilës është bërë vlerësimi i ndikimit në mjedis për objektet kryesore dhe ato përcjellëse me veprimtarinë e lartëcekur, përfshinë disa faza si në vijim:

a).Faza 1 - Mbledhja e informatat themelore rreth:burimeve themelore të ndikimeve në mjedis, popullatës ekzistuese me karakteristikat demografike, karakteristikave të Formacioneve litologjike argjilore , topografisë dhe gjeomorfologjis dhe reliefit në Objektivin të lartpërmendur, klimës së Objektivit me të dhënat meteorologjike, vetë Fabrika NPt Ferplast në Objektivin për prodhimin e tubave të plastikës .

b) Faza e 2- të dhënat e florës dhe faunës -botës bimore dhe funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

- Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e

ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

, madhësia dhe lloji i ndotjes nëse identifikohet , gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar dhe Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Faza 3 - Analiza e rrezikimit të:njeriut, vlerave materiale ,vlerave natyrore

d) Faza 4 - Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në Objektin e lartë cekur në kuadër të NPT Ferplast

8.9.2. ELEMENTET BAZË PROGRAMORE NË HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM.

Nga informatat e grumbulluara të cilat kanë të bëjnë me elementet nismëtare për hartimin e këtij elaborati të VNM , me rëndësi të veçantë janë të dhënat që kanë të bëjnë me karakteristikat sasiore të gjendjes ekzistuese të karakteristikave natyrore. Karakteristikat e lokacioni me objektet kryesore dhe atyre përcjellëse me veprimtarinë e lartëcekur janë paraqitur detajisht në mënyrë të specifikuar hollësisht në dokumentacionin e projektit teknikë dhe këto janë shfrytëzuar gjerësisht gjatë hartimit të Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis.

4.9.3. Metodologjia e HulumtimitPavarësisht nga qëndrimet tanimë të përmendura lidhur me problematikën e mbrojtjes së mjedisit dhe karakteristikat e caktuara metodologjike të zbatuara për nevojat e këtij hulumtimi studimor të thjeshtësuar, ekzistojnë një sere faktesh të cilat kërkojnë që metodologjia e zbatuar të definohet që në fillim.

Analiza e tillë është e nevojshme pasi që mundëson krahasimet e nevojshme të metodologjisë së shfrytëzuar për nevojat e këtij hulumtimi me bazat metodologjike të proklamuar në kuadër të rregullativës ligjore e cila e mbulon këtë problematikë. Qëllim themelor qëndron në përpjekjen që metodologjia e përgjithshme ti adaptohet veçorive të lokacionit me objektet kryesore dhe atyre përcjellëse me veprimtarinë e lartëcekur që zhvillohet.

8.9.3.. POTENCIALET EKZISTUESE

Hapi kyç i hulumtimit të gjendjes ekzistues të mjedisit është potenciali ekzistues , që konsiston me analizën e mirfilltë të tërësisë hapsinore në zonën më të gjërë të objektit PËR PRODHIMIN E TUBAVE TË PLASTIKËS NE KUADËR TË NPT"FERPLAST' , me detyrë që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjikë dhe në bazë të tyre të bëhen rekomandimet për zvoglimin apo eliminimin total të ndikimeve të mundshme negative.

Gjendja e potencialit ekologjik përbëhet nga veprimi i ndikimeve të ndërsjellta të faktorëve natyrorë siç janë toka , uji , ajri, reliefi, flora, dhe fauna. Ndikimi i ndërsjellët i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrdhënieve të mundshme , do ta paraqesim në skemën 2 në vijim.

Në bazë të raporteve të paraqitura në skemë vërehet qartë se faktorët natyrorë formojnë disa potenciale natyrore karakteristike funksionet e të cilëve duhet marrë parasyshë gjatë valorizimit të ndikimit të kompleksit të planifikuar në hapsirën konkrete.




Figura 9 . Pamja e Skemës nr 2 - mardhanjet bazë në mes faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike

Njiherit edhe gjatë elaborimit jemi bazuar në potencialet ekzistuese të tokës, klimës dhe në përgjithësi të ekosistemeve dhe biotopit. Hulumtim i këtyre potencialeve ekzistuese ekologjike është bërë në këtë fazë kryesisht për shkak të vlerësimit të ndikimeve të mundëshme që do të ishin si pasojë e procesit të punës së në NPT FERPLAST

Potencialet e tokës paraqesin karakteristikën themelore të lokacionit të analizuar.

Potencialet e ujit janë analizuar duke marrë në konsiderim karakteristikat hidrografike të regjionit të gjerë, gjendjen e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore. Ndikimet e mundshme përcaktohen në kuptim të humbjes së karakteristikave natyrore, humbjes së efektit të funksioneve natyrore në ekosistemet natyrore si dhe çrregullimet e mundshme që mund të shkaktohen në biosferë, duke përfshirë këtu botën e gjallë dhe faktorin njeri, si rregullues i biosferës dhe degradues gjatë punës së tij në ambientin ku jeton dhe vepron.

Potencialet ekzistuese klimatike para së gjithash janë të përcaktuara me karakteristikat klimatike të regjionit të analizuar. Treguesit themelorë janë marrë nga të dhënat shumëvjeçare meteorologjike të mbledhura në rezervuarin relevant meteorologjikë. Analiza e rrezikut ekologjikë në lëmine e biotopeve është bërë ashtu që marrëdhëniet të cilat karakterizojnë secilin biotop të rëndësishëm të sistemohen dhe të definohet mundësia e humbjes së potencialeve të tyre.

9.0. PËRFUNDIM

Në Objektin ku zhvillohet veprimtaria e lartë cekur te npt “ Ferplast”., nuk ka emitim të substancave të rrezikshme në ajër, ujë dhe me potencial të rëndësishëm për rrezikim të shëndetit dhe të mjedisit nëse zbatohen të gjitha masat mbrojtëse të cilat janë rekomanduar në këtë Raport të VNM.

Gjatë punës normale në këtë Objekt për prodhimin e tubave të plastikës duhen respektuar të gjitha masat mbrojtëse rregullativa ligjore në fuqi për të cilat pronari është i informuar dhe njëkohësisht për Objekte prodhuese të tubave në ferizaj i ka plotësuar të gjitha kriteret, pasi që ka një përvojë dhe kapacitet për të i implementuar edhe kriteret për mbrojtjen mjedisit edhe për këtë e ka përgatitur tërë dokumentacionin dhe terrenin ku do të zhvillohet puna.

Sa i përket destinimit të ngastrës që tani është në zonën industriale Babushi i Ri, aktivitetet e që do të zhvillohen brenda ngastrës nr 000913-0 zhvillohen më infrastruktural të kompletuar.

Trajtimi dhe përdorimi i ngastrës sipas destinimit gjithnjë do të ketë përdorim sipas statusit të zonës industriale në Babush i Ri, zona kadastrale Babush i Serbëve

Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës në impiantin në fjalë të cilat ndikojnë në mjedisin jetësor dhe duke i zbatuar të gjitha masat e përmendura nga kjo analizë e bërë dhe duke pasur parasysh kapacitetin e Kompanis NPT Ferplast në fjalë dhe mjedisin rrethues të lokacionit mund të konkludojmë se veprimtaria prodhimin e tubave të plastikës në kuadër të kompanis NPT : Ferplast” Komuna Ferizaj . Nuk shkakton ndikime negative në mjedis dhe nuk rrezikon shëndetin e njeriut dhe në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit , duke u bazuar edhe nga puna në terren , pozita e ngastrës , plotësimi i dokumentacionit tekniko investim , besojm se në tërësi i ka plotësuar kriteret mjedisore krahas zhvillimit të aktivitetve në Objektin për prodhimin e tubave nga plastika në kuadër të NPT : Ferplast” , sipas kërkesës të kompanisë në DMMU në kuadër të MMPHI, mendojmë se kjo kërkesë për pëlqim mjedisor do të aprovohet pasi që investitori i kompanisë posedon tërë dokumentacionin tekniko-investiv dhe raportin e VNM

Gjatë punës normale që zhvillohet me veprimtarin për prodhimin e tubave në fabrikën NPT : ferplast” ,duhet të respektohen të gjitha masat mbrojtëse mjedisore dhe rregullativat ligjore në fuqi.

Unë Mr.inxh.dipl.Vehbi Goxhuli konstatoi: se nuk e dëmton mjedisin (tokën, ajrin, ujin dhe resurset natyrore) në fazën e tanishme, duke u bazuar në faktet në terren dhe konsulta me aplikuesin, njëherit nuk ndikon negativisht në resurset natyrore dhe njerëzore, dhe i plotëson kushtet apo është lokacion adekuat për të ushtruar veprimtarin për prodhimin e tubave të plastikës.

10. LITERATURA

1. PLANIT I ZHVILLIMIT URBANISITIK TË KOMUNËS SË FERIZAJT.
2. HARTA NGA GJEOPORTALI I KPMM, DHE AEROFOTGRAFIA AR-GIS
3. LEGJISLACIONI I MMPHI.
4. INCIZIMI DHE PUNA NË TERREN .
5. KONSULTIMI I VAZHDUESHËM ME INVESTITORIN

PËRMBAJTËJA :

1.0	HYRJE	4
2.0.	BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VNM-SË	6
3.0.	BAZA LIGJORE PËR HARMONIZIMIN E KRITEREVE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	8
4.0.	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT GJATË PËRGATITJES SË RAPORTIT TË VNM	10
4.1.	METODOLOGJIA DHE PJESA E PËRGJITHSHME	11
5.0.	HULUMTIMI DHE POZITA E NGASTRËS SIPAS ZONËS KADASTRALE	12
5.1.	HISTORIK I SHKURT PËR KOMUNËN E FERIZAJT	14
6.0.	KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE, KLIMATERIKE, HIDROGJEOLOGJIKE, METEOREOLOGJIKE ,PEDOLOGJIKE DHE SEIZMIKE TË TERRENIT	17
6.2.	KUSHTET KLIMATIKE	18
6.4.	HIDROGJEOLOGJIA DHE HIDROLOGJIA	21
6.5..	KARAKTERISITIKAT PEDOLOGJIKE , NATYRA DHE BIODIVERSITETI , FLORA DHE FAUNA	21
6.6.	KRITERET SEIZMIKE	23
6.8.	ZHURMA - NDOTJA AKUSTIKE	25
6.9.	VIBRACIONET	26
7.0.	PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË TUBAVE NGA PLASTIKA DHE PËRSHKRIMI DHE KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PROCESIT TË PRODHIMIT	29
7.1.	PROQESI I PRODHIMIT	33
7.2.	PËRSHKRIMI I KUSHTEVE EKZISTUESE MJEDISORE	44
7.3.	KOMPONENTA E UJIT	45
7.4.	KOMPONENTA E AJRIT	47
7.5.	GRUMBULLIMI I MBETJEVE TË NGURTA	47
7.6.	ZONAT E MBROJTURA NATYRORE- TRASHEGIMIA KULTURORE	48
8.0.	NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	49
8.9.	PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR	58
9.0.	PËRFUNDIM	63
10.	LITERATURA	63
11.0.	PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË VNM	65

HARTUESI E RAPORTIT PËR VNM

Mr.inxh.dipl.Shken.teknike. Vehbi Goxhuli Nr.i licensës 25/19

TEL: : 044/330322 DHE 049/380301

E-mail:vehbigoxhuli@gmail.com; vehbigoxhuli@yahoo.com